

Vjenë, 27 prill 2020

Shumë të nderuar prindër, shumë të nderuar persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte)!

Javët e fundit ishin sidomos për ju një periudhë veçanërisht e ngarkuar. Shumë prej jush qenë të detyruar ta organizonin aktivitetin e tyre profesional nga shtëpia. Në të njëjtën kohë sistemi shkollor u çaktivizua dhe u transformua në një mësim në distancë (Distance Learning). Ky vendim nuk ka qenë i lehtë për qeverinë federale dhe për mua si drejtues i ministrisë përkatëse. Por ai ishte i domosdoshëm për mbrojtjen e popullsisë dhe të të gjithë atyre që mësojnë e japin mësim në shkollat tona.

Brenda një kohe të shkurtër ne zhvilluam disa modele për mësimin në distancë, u përpoqëm ta përmirësojmë pajisjen e nxënësve dhe nxënësve tona me mjete digjitale dhe vumë në dispozicion materiale mësimore digjitale. Ngritëm një fond të veçantë për udhëtimet dhe aktivitetet shkollore që nuk mund të zhvilloheshin për t'i ndihmuar prindërit dhe personat me të drejtë kujdestarie në ato raste kur shpenzimet e paguara nuk u ktheheshin. Veç kësaj, përgatitëm një model për zhvillimin e maturës dhe të provimeve përfundimtare në kohën e virusit korona.

Mirëpo shkolla është shumë më tepër sesa një vend mësimi. Të rëndësishme janë gjithashtu kontaktet sociale dhe miqësitë që krijohen në klasa, si dhe takimi me fëmijët e të rinjtë e tjerë apo me mësueset e mësuesit. Të gjitha këto tregojnë sa me rëndësi është hapja e shkollave për shoqërinë tonë.

Prej fillimit të prillit po vërejmë një stabilizim të numrit të infeksioneve. Në shumë fusha të jetës publike dhe ekonomike po bëhen tani përpjekje për të vendosur një normalitet të ri dhe për të rifilluar punën. Pas shumë konsultimesh dhe në marrëveshje me kancelarin federal e ministrin e shëndetësisë ka ardhur tani momenti për të bërë hapin e radhës në fushën e sistemit shkollor.

Për këtë kemi hartuar një strategji të qartë, që bazohet në pikat kyçe të mëposhtme:

- Shkollat nuk do të hapen për të gjithë në të njëjtën kohë.
 - Fillimisht do ta hapim shkollën për më të rriturit, të cilët janë duke e përfunduar shkollën. Duke nisur nga data 4 maj do të rikthehen në shkollë maurantet dhe maurantët, si dhe të gjithë nxënëset e nxënësit e vitit të fundit në shkollat profesionale.
 - Etapa e dytë fillon më 18 maj. Ajo përfshin të gjithë nxënësit e moshës 6-14 vjeç, pra shkollat fillore, klasat e ulta të gjimnazit (AHS-Unterstufen), Shkollën e Mesme të Re (NMS) dhe shkollat e posaçme (Sonderschule).
 - Nëse gjithçka ecën mirë dhe infeksionet nuk rriten përsëri, vijon etapa e tretë e hapjes së shkollave më 3 qershor. Atëherë do të hapen shkollat politeknike, klasat e larta të gjimnazit (AHS-Oberstufe), si dhe shkollat e mesme e të larta profesionale.

Etapa e dytë dhe e tretë fillojnë në një ditë të premte – me një konferencë të stafit mësimor. Qëllimi është që ta përgatisin mirë fillimin e shkollës për nxënëset dhe nxënësit në javën që vijon.

- Puna në shkollë do të organizohet në përputhje me pesë parimet e mëposhtme:

1. Rrallim i njerëzve nëpërmjet punës me turne
2. Lënda mësimore: më pak do të thotë më shumë
3. Vlerësim me urtësi
4. Respektim i udhëzimeve higjienike
5. Përgjashtim për persona të caktuar

Unë kam kërkuar nga drejtoreshat dhe drejtorët e shkollave që ndarjen e punës në turne ta bëjnë

- deri në datën 4 maj për nxënëset dhe nxënësit e shkollave fillore, shkollave të mesme të reja (NMS) dhe klasat e ulta të gjimnazit
- deri në datën 15 maj për nxënëset dhe nxënësit e tjerë.

Në këtë mënyrë ju do të keni kohë që ta organizoni ditën tuaj të punës dhe të përgatiteni së bashku me familjen tuaj për rrethanat e reja. Të gjitha informacionet më të detajuara do t'i merrni direkt nga shkolla që frekuenton fëmija juaj.

Për të gjithë nxënëset e nxënësit që do të vijnë në shkollë, gjatë riaktivizimit gradual të punës në shkollë, ne do të kujdesemi për mbajtjen e rregullave të rrepta higjienike. Por nëse ju nuk doni ta lini fëmijën tuaj të rikthehet në shkollë, sepse shqetësoheni për shëndetin e tij, mungesa e tij konsiderohet e justifikuar. Ju lutemi, njoftoni lidhur me këtë drejtorinë e shkollës ose mësuesin kujdestar, fëmija juaj mund ta studiojë pastaj lëndën përkatëse nga shtëpia.

Ne e dimë që kjo rrugë nënkupton një punë në tehtë brishtë. Ajo është rezultat i vënies në kandar nga njëra anë të mbrojtjes së shëndetit dhe nga ana tjetër të detyrimit për të siguruar në mënyrë afatmesme e afatgjatë shanset e fëmijëve dhe të rinjve tanë për t'u arsimuar e punësuar. Ju lutemi të ndihmoni edhe ju që kjo rrugë të na dalë me sukses.

Ju uroj juve dhe familjeve tuaja gjithë të mirat. Së bashku do t'ia dalim që t'i përgatisim mirë fëmijët dhe të rinjtë tanë për të ardhmen, pavarësisht nga kriza e shkaktuar prej virusit korona.

Përshëndetje miqësore

Juaji



Heinz Faßmann

Univ.-Prof. Dr. Heinz Faßmann
Bundesminister für Bildung,
Wissenschaft und Forschung
(Ministër federal për Arsimin, Shkencën dhe Hulumtimin shkencor)